

**Njoftim për përqendrimin me të cilin Aricoma a.s. Çeki do të fitoj kontrollin mbi CLARISTONE s.r.o.
Çeki**

(lënda nr. 08-143/2024)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), 208/24 më 24.10.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin Aricoma a.s. (Aricoma a.s.), me seli të regjistruar në Vinohradska 1511/230, 100 00 Pragë 10 Republika Çeke synon të fitojë kontrollin e plotë mbi CLARISTONE s.r.o. (Clarystone s.r.o) me seli në Na Vjetrojve 889/13, Lhotka, 142 00 Pragë 4, Republika Çeke.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Aricoma a.s. është një kompani holding që menaxhon pjesët në kompanitë e saj simotra - veçanërisht Aricoma Systems a.s. (Aricoma Systems a.s.) (i njohur më parë si Autocont AEC a.s.), Sabris Konsalting s.r.o dhe Aricoma Enterprajs Sabejsekjuriti a.s. (Aricoma Eterprise Cybersecurity a.s). Aricoma Systems a.s. fokusohet në zbatimin e ndërmarrjeve të mëdha dhe projekteve të mëdha të klientëve, zbatimin dhe mbështetjen e sistemeve të informacionit të biznesit të Microsoft Dynamics dhe ofron infrastrukturën e IT, aplikacionet e korporatave, mbështetjen e procesit të biznesit, kujdesin ndaj klientit dhe sigurinë e IT. Sabris Konsalting s.r.o. fokusohet në ekspertizën e SAP, zgjidhjet e biznesit dhe shërbimet përkatëse. Aricoma Enterprajs Sabejsekjuriti a.s. ofron teknologjitë e sigurisë, vlerësimin e sigurisë, shërbimet e mbrojtjes kibernetike dhe shërbimet këshillimore të GDPR/përputhshmërisë. Aricoma a.s. i përket Grupit KCCG.

Grupi KCCG investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë llotaritë dhe lojërat e fatit, energjinë, pasuritë e paluajtshme dhe teknologjitë e informacionit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KCCG është i pranishëm në treg për të punuar me терминалет e video lotarisë dhe teknologjitë e informacionit përmes shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIA SHPK Shkup, me aktivitet prioritar - lojëra të fatit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me aktivitet prioritar - lojërat e fatit dhe basteve;
- Kinshift SHPKNJP Shkup, më parë i njohur si Seavus SHPKNJP Shkup me aktivitet prioritar - programim kompjuterik; dhe
- Shoqëria për edukim kompjuterik dhe zhvillim të inovacioneve Kinshift AKademi SHPKNJP Shkup, më parë e njohur si qendra arsimore dhe zhvillimore Seavus SHPKNJP Shkup, me aktivitet prioritar - arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër;
- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Musala Soft SHPKNJP Shkup - me aktivitet prioritar - programim kompjuterik.

CLARISTONE s.r.o ka një aktivitet prioritar në sektorin e integrujesve të sistemit IT që ofron zgjidhje për transmetimin e të dhënave, zërit dhe imazhit.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

29.10. 2024